

Efektet e aparatit Hyrax në zgjerimin transversal të harkut dentar maksillar

Sali F.¹, Carçeva – Shalja S.², Najdenoska – Bojchinoska S.³, Dovolani T.⁴, Andonoska S.⁵, Mehmeti B.⁶

¹Qendra klinike stomatologjike " Shën Pantelejmon" – Shkup – Republika e Maqedonisës ë Veriut;

²Fakulteti i shkencavemjekësore – Universiteti Goce Dellçev – Shtip - Republika e Maqedonisës ë Veriut;

³ISHM Qendra Shëndetësore – Krushevë - Republika e Maqedonisës ë Veriut;

Hyrje: Aparati Hyrax është një pajisje për zgjerimin e shpejtë të nofullës, i cili jep forcë në suturën palatale të maksillës, duke rezultuar në korrigjimin e mungesës së zhvillimit të tërthortë të nofullës. Kjo teknikë ortodontike zakonisht përdoret për korrigjimin e nofullës së ngushtë dhe kafshimit të kryqzuar të pasëm.

Materiali dhe metoda: Pacienti i përfshirë në këtë studim, 13 vjeç, është trajtuar në klinikën tonë, me diagnose malokluzion te klasit II të divizionit 1. Plani i trajtimit përfshinte dy faza.

Qëllimi: i këtij prezantimi të rastit është të tregojë efektin skeletor të zgjeruesit Hyrax, duke prodhuar dhe dhënë force në suture palatale që rezultojnë në korrigjimin e kafshimit të kryqzuar të pasëm dhe korrigjimin e përgjithshëm të malokluzionit të klasës II/1.



Pamja para trajtimit



Profili para trajtimit



Modeli i studimit para trajtimit

Faza e parë përfshinte qasjen më aktive duke përdorur Hyraxin për zgjerimin e shpejtë maksilar (RME).



Hyrax i aplikuar



Ekzaminimi intraoral i hyrax-it të aplikuar

Dhe faza e dytë vazhdoi me trajtimin ortodontik me aparat fiks ortodontik në nofullën e sipërme dhe të poshtme. Faza e dytë e trajtimit përfshinte edhe nxjerrjen e premolarëve të parë të sipërm.



Aplikohet aparat fiks ortodontik

Rezultatet: Pas 7 javësh trajtim aktiv me aparatit Hyrax dhe 6 muaj periudhë stabilizimi, trajtimi ortodontik vazhdoi me aparat ortodontik fiks. Trajtimi i përgjithshëm ortodontik ka përfunduar pas një periudhe 29 mujore, me korrigjim të kafshimit në të tre dimensionet.



Harku dentar pas trajtimit



Harku dentar pas trajtimit



Harku dentar pas trajtimit



Harku dentar maksilar pas trajtimit

Konkluzioni: Nëpërmjet këtij prezantimi rasti konkludohet se zgjerimi i shpejtë maksilar me aparatit Hyrax në kombinim me aparatit ortodontik fiks, jep rezultate të shkëlqyera në trajtimin e kafshimit të kryqzuar posterior të pranishëm në pacientët e klasit II. Trajtimi ortodontik rezultojnë në një pamje të ekuilibruar të fytyrës me buzëqeshje tërheqëse.